

STATUT I SHOQERISE TREGTARE

“AFS Engineering” SH.P.K

Shoqeria tregtare “AFS Engineering” SH.P.K krijohet ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare “,ligjin129/2014 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14.4.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” te ndryshuar , dhe ne zbatim me ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

KREU I

Dispozita te pergjithshme

NENI I

Shoqeria “AFS Engineering”SH.P.K eshte person juridik shqiptar.
Ajo gezon personalitetin juridik qe nga momenti i regjistrimit ne Regjistrin Tregtar dhe ne Organin tatimor.
Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e themelimit (Akti i Themelimit dhe Statuti)

NENI 2

Shoqeria “AFS Engineering” SH.P.K eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me seli ne ne adresën :

**ELBASAN Lagjja Luigj Gurakuqi, bulevardi "Aqif Pasha", hotel "Skampa",
dyqani nr.3**

Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

NENI 3

Afati i veprimtarise se Shoqerise do te jete i pakufizuar, me perjashtim te rastit kur ortakët vendosin prishjen e saj.

NENI 4

Emertimi i shoqerise eshte “AFS Engineering” SH.P.K

Honore Sëni
[Signature]

Ky emertim vendoset ne te gjitha letrat qe perdoren per korespondence ne faturat, ne te gjitha reklamat dhe botimet e nxjerra prej saj dhe do te pasohet nga fjala " sh.p.k " ose " Shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar" nga numri i regjistrimit te saj dhe selia.

KREU II
Objekti i veprimtarise

NENI 5

Objekt i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Projektim, instalim, mirembajtje impiantesh elektrike. Prodhim te impianteve te gjenerimit te energjise elektrike, si dhe projektim instalim dhe mirembajtje impiantesh telekomunikacioni. Dhe cdo aktiviteti tjeter te nevojshem lidhur me objektin e veprimtarise ne perputhje me legjislacionit Shqipetar.

NENI 6

Themeluesi i shoqerise rezervon te drejten te modifikojne objektin e veprimtarise ne cdo kohe.

KREU III
Kapitali themeltar

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kontributet ne para dhe eshte 100000leke shqiptare. Ortaku **Z. Florenc Skuqi zoteron nje kuote me vlere 100000 leke ose 100 % te kapitalit themeltar.**

KREU IV

NENI 8

Ortaku ushtron kompetencat qe i jane caktuar , ne baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare " dhe ligjit 129/2014 . Ai merr vendime per veprimtarine e shoqerise dhe politiken ekonomike e tregtare te saj .

Florenc Skuqi

NENI 9

Vendimet ne emer te ortakeve merren sipas parashikimeve te percaktuara ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise. Ortaket marrin vendime per ceshtjet e meposhtme:

Miratojne strukturen organizative te shoqerise dhe numrin e vendeve te punes.

Emerojne dhe shkarkojne Administratorin e shoqerise.

Administrator i Shoqerise emerohet **Z.Emitjaz Spahiu** i pajisur me numer personal **J80316060K**, me kohezgjatje te mandatit per **5 vjet**.

Ndryshojne e modifikojne statutin e shoqerise, kapitalin themeltar e objektin veprimtarise se shoqerise, si dhe ndryshimin e formes juridike te shoqerise.

Miratojne llogarite pas raportit te eksperteve kontabel.

Vendosin per prishjen e shoqerise.

Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.

Riorganizimin, mbarimin dhe prishjen e shoqerise dhe likuidimin e saj.

Orientimet ne baze te cilave do te drejtoje veprimet shoqeria, e do te caktojte preferencat e politikese se saj ekonomike e tregtare.

Ndermarrjen e aktiviteteteve te reja afariste.

Dhenien per peng ose hipoteke apo siguri tjeter te ngjashme.

NENI 10

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne maredhenie me te tretet ne emer te shoqerise si dhe ato te percaktuara ne ligjin nr 9901 date 14.04.2008 dhe ligjin 129/2014.

Ai ka te drejta te plota per drejtimin operativ te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha veprimet qe duhen per aktivitetin e shoqerise.

Administratori perfaqeson shoqerine ne te gjitha veprimet juridike e financiare te saj me pale te tjera, me banka, shoqeri transporti, e tjere.

Administratori mund te heqe dore ne cdo kohe nga detyra e tij, nepermjet nje njoftimi me shkrim drejtuar asamblese se ortakeve. Administratori qe jep doreheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarise se shoqerise eshte gjithshtu i detyruar te kerkoje nga asambleja e ortakeve te marre vendim per emerimin e administratorit te ri, perpara dates ne te cilen doreheqja te hyje ne fuqi.

Nese asambleja e ortakeve nuk vendos emerimin e administratorit te ri ne daten e percaktuar ne thirrjen e kryer nga administratori i dorehequr, atehere administratori njofton me shkrim doreheqjen Qendres Kombetare te Regjistrimit sebashku me kopjen e thirrjes se mbledhjes se asamblese se ortakeve dhe Qendra Kombetare e regjistrimit regjistron largimin e administratorit sipas procedurave te ligjit 9723 date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit te ndryshuar.

Flonore Sejdi

NENI 11

Ortakët emerojnë deri në dy eksperte kontabel për një periudhë kohe prej 6 vitesh financiare të cilët ushtrjnë kontroll të veprimtarisë së shoqërisë. Ekspertët kontabel bëjnë të gjitha verifikimet e kontrollet që gjykojnë të nevojshme, në çdo kohë të vitit dhe të dy bashkë ose veç e veç. Ata mund të shqyrtojnë në vend të gjithë dokumentacionet e shoqërisë që e vlerësojnë të dobishme në ushtrimin e detyrës së tyre.

KREU V

Veprimtaria e shoqërisë

NENI 12

Viti ekonomik financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Viti i parë financiar fillon në datën e themelimit të shoqërisë. Pagimi i pagave, taksave të tatimeve dhe i kuotave për sigurimet shoqërore do të bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse në fuqi.

NENI 13

Shoqëria do të mbajë librin e llogarive në lekë dhe në valute të huaja dhe do të bëjë përlogaritjet për nxjerrjen e bilancit në përputhje me ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

NENI 14

Emerimi dhe marrja në punë, caktimi i pagesave për çdo punonjës dhe largimi nga puna janë kompetencë e administratorit.

Mardhëniet e punës me shoqërisë si punëdhënëse dhe punëmarësve rregullohet me kontratat e punës dhe legjislativën në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

KREU VI

Prishja, shpërndarja dhe likuidimi

NENI 15

Flavie Shupi

Shoqeria mund te shperndahet per shkaqet e meposhtme:

- a) Me vendim te asamblese se ortakeve.
- b) Me humbjen e gjysmes se kapitalit themeltar, pasi te jete shpenzuar dhe fondi rezerve.
Ne rast se ortakët nuk marrin vendim per te plotesuar kapitalin ose zvogeluar ate ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- c) me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.
- d) ne rast se objekti behet i parealizueshem per shkak te mosfunksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare.
- e) ne rastet e pavleshmerise se themelimit te shoqerise
Ne rastin e prishjes se shoqerise , shoqeria do te likuidohet .
Ortakët duhet te caktojne nje ose disa likuidatore.
Likuidimi i shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe ligjit nr 129/2014..

NENI 16

Te pakten 15 dite perpara dates se aprovimit te llogarive te shoqerise, keto llogari duhet te jene ne dispozicion te ortakeve ne seline e shoqerise.
Administratori do te percaktoje rregullat operative per ti bere te mundur ortakut konsultimin e librave te llogarive te shoqerise te pakten 2 here ne vit.

NENI 17

Persa nuk eshte e parashikuar nga statuti i tanishem do te zbatohet legjislacioni ne fuqi.

Date 21/08/2021

STATUTI I SHOQERISE “AUTO KRASNIQI” SH.P.K.

ORTAKU

Z. Florenc Skuqi